

P.nr.173/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbeër prej gjyqtarit Xheladin Osmani, si kryetar dhe gjyqtarve Artan Sejrani dhe Gani Kastrati, si anëtar të trupit gjykues, në lenden penale kunder të akuzuarit D.F. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nenp.1.1 të KP, veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP dhe veprës penale përdorimi i armes apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren,- Departamenti i krimeve të rënda, PP.nr.194/2016, e dt.04.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore publik, më datë:02.02.2017, në prezencen e prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av.E.G., dhe perfaqësuesit të demtuars av.R.K., po në të njejtën ditë, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.F., nga i ati H. dhe e ëma N., me mbiemer të vajzërisë S., i lindur më dt.”data e lindjes...”, në Prizren, me banim në Prizren, në rrugën “.... ..”, nr. ... , shqipëtar, shtetas i R. të Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijve, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

I.Me dt.05.08.2016, rreth ores 22:35minuta nëPrizren, në lokalin e natës “.....” në lagjen “.....”, i akuzuari i shkakton lëndim të rëndë trupor me armës zjarri të dëmtuarës L. M., punëtore e lokalit, në atë mënyrë që pas një mosmarëveshjeje të mëherëshme që kanë patur i akuzuari dhe e dëmtuara, me pistoletën e markës model “TT” të kal.7.62 mm, në një afërsi gjuan një here nëdrejtim të dëmtuarës L.M. dhe e plagosë në kofshën e djathtë e pastaj e tërheqë zvarrë deri në tavolinën e tij, ashtu që i shkakton lëndime të rënda trupore, plagë me armë zjarri, thyerje e hapur shumë pjesësse e ashtit të kofshës së djathtë, më së afërmi të përshkruar sin ë mentimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr.Sc.F. B. , të dates 17.08.2016 dhe 29.09.2016.

Më këtë ka kryer vepren penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nenp.1.1 të KP.

II. me datën, vendin dhe kohën e njejtë të përshkruar sin ë dispozitivin nën I/ posedom pa leje valide pistoletën e modelit “TT” të kal.7.62 mm, me numër serik-...-.... si dhe 2 fishekë të kal.7.62 mm, me një karikator, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja, në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP.

III. Me datën kohën, vendin dhe kohën e njejtë pas kryerjes së veprës penale të përshkruar sin ë dispozitivin nën I/ përdorë armën, pistoletën në mënyrë kërcnuese ose frikësuese ndaj D.B., në

atë mënyrë që pasi D.B. i thotë që të largon armën, i akuzuari D.F. e ndjek duke e drejtuar armën deri në banak.

Më këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshlëm nga neni 375 par.2 të KP.

Gjykata në bazë të nenit 3,7,8,9,10,21,,41,42,43,45,46,73,74,75,76 të KP ,

V e r t e t o n

Të akuzuarit D.F., për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KP, ia shpall dënimin me burg në kohëzgjatje prej 12 (dymbdhjetë) muaj.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, ia shpall dënimin me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) euro.

Për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshlëm nga neni 375 par.2 të KP. ia shpall dënimin me gjobë në Shumën prej 1000 (njëmijë) euro dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Gjykata në kuptim të nenit 80 të KP,

G J Y K O N

Me dënim UNIK, me burg në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, ku do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtepiak prej datës 05.06.2014 gjërë më dt.25.07.2014, dhe masa e arrestit shtepiak prej dt.05.08.2016 gjërë më dt.04.01.2017, dhe dënimin UNIK me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë) euro.

Nese i akuzuari D.F., dënimin me gjobë nuk mundët apo nuk deshiron ta paguaj në në afatin e lartëcekur, gjykata në të kundërtën për qdo 15 euro dotë ia caktoj një ditë burgim.

E demtuara L.M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari D.F. të paguaj edhe paushallin gjyqësor 100 (njëqindë) euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

Gjykata, në bazë të nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 të KP, ndaj të akuzuarve shqipton dënim plotësues;

MARRJEN E SENDIT

Ashtu që prej të akuzuarit D.F., mirret arma –pistoleta e tipit “TT, e kalibrit 7.62 mm,-...-... si dhe 2 fishekë të kal.7.62 mm, me një karikator.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzen PP.nr.194/2016, e dt.04.10.2016 ndaj të akuzuarit D.F. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nenp.1.1 të KP, veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP dhe veprës penale përdorimi i armes apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP, aktakuzë të cilën në shqyrtimin kryesor e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa.

Prokurori i shtetit – Mehdi Sefa në fjalën e tij përfundimtare thekson: pasi që i akuzuari ka pranuar fajsinë për veprat penale që janë objekt i aktakuzës, gjykatës i propozojë që i njejtë të shpallet fajtor dhe të gjykohet në bazë të Ligjit. Gjatë zbatimit të dënimit gjykatës i propozojë që prej rrethanave rënduese të ketë parasysh peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit sidomos rrethanat nën të cilat i ka kryer këto vepra penale, kurse prej rrethanave lehtësuese qëndrimi i tij korrekt dhe të sinqertë para gjykatës, dhe faktin se për këto vepra penale e ka pranuar fajsinë.

Gjykatës i propozojë që të njejtë tia shqiptojë dënimin plotësues të konfiskimit të pistoletës, të markës “Model TT” kal.7.62 mm, me 2 fishekë të kal. Të njejtë, mjet me të cilin i ka kryer këto vepra penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës L.M., avokati R.K. deklaron: e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare, përfaqësuesit të akuzës, parashtrojë kërkesë pasurore juridike dhe për këtë do të deklarohej në vonë në kontestin e rregullt civil.

I dëmtuari D.B., gjithashtu mbështetë fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të akuzës, mirëpo nuk parashton kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.F., avokati E.G. deklaron: pas pranimit të fajsisë nga i mbrojturi im mu nuk më ngel gjë tjetër ta lus trupin gjykues që gjatë marrjes së vendimit mbi sanksionin penal ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e sidomos pendimin e tij premtimin se në të ardhmen do të jetë i përmbajtur, për herë të parë është vënë ndesh me Ligjin, pasoja e shkaktuar edhe te ky ka ndikuar për shkak se akoma është në raporte në bashkëshortësi, i propozojë gjykatës që të bëjë zbutjen e dënimit konformë nenit 76 të KP, par.1 1.3 për secilën vepër penale ashtu që edhe me një dënim nën minimumin e paraparë ligjore shpresojë dhe jam i bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari D.F., në tërësi mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit, avokatit të tij, deklaroi se pendohet për veprat që i ka kryer, dhe jep fjalën gjykatës se ma në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepra penale.

Vepra penale lëndimi i rëndë trupor neni 189 par.5 të KP, parr 1 nenp 1.1 të KP.

kur vepra penale parr 1,2 ose 3 të këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm pao me ndonjë send tjetër që mundë të shkaktoj lëndim të rëndë ose demtim të rëndë të shendetit , kryesi denohet...

Vepra penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose në posedim të paautorizuar të armeve.

Kjo qeshtje rregullohet ne nenin 374 par.1 të KP. “kushdo që mban në pronësi, kontrolle ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla , dënohet...”

Trupi gjykues konsideron se kontrolli përfshin ruajtjen apo mundësin e qasjes së armës dhe posedimi përfshin posedimin personal të armës njësoj sikur ta kesh armen.

Arma- pistoleta e tipit “TT, e kalibrit 7.62 mm,-...-...e kalibrit 7.62 mm, të cilën e ka përdorur i akuzuari D.F., si armë zjarri, gjithashtu ky nen e përkufizon municionin për armë zjarri si armë dhe sipas Ligjit për armët për të cilat nuk mundë të mirret leja nga personi fizik.

Vpra penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP.

kushdo që përdor armen apo mjetin e rrezikshëm , në mënyrë kërcnuese ose fikësuese, denohet me

I akuzuari D.F., në shqyrtimin kryesor ka pranuar fajsinë në të gjitha pikat e akatakuzes, veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me parr 1 nenp 1.1 të KP. për veprat penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga nei 374 par.1 të KP si dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP.

Në bazë të pranimit të fajsisës nga ana e të akuzuarit D.F., vertetue në tersi pretendimi i Prokurorisë Themelore në Pritzren, Departamenti për Krime të Rënda, të shprehur në si nen I, II/ dhe III/ të dispozitivit të aktakuzes PP.nr.194/2016 të dt.04.10.2016.

Trupi gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari D.F. e pranoi fajësinë për veprat penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me parr 1 nenp 1.1 të KP. për veprat penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga nei 374 par.1 të KP si dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e po ashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që u vihet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës lëndimi i rëndë trupor neni 189 par.5 të KP, parr 1 nenp 1.1 të KP. Veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KP dhe se i akuzuari D.F. është përgjegjës në aspektin penal- juridik, për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 par.1 p.1.3 të KP, pati parasyshë të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë posaqërisht lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë tërë procedurës, pranimin e fajësisë, është penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritë vepër të njëjtë penale dhe gjerë më tani i padënuar, për këtë gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 373 par.5 dhe nenit 69 të KP-së.

Vendimi mbi kerkesën pasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti për krime të rënda

P.nr.173/2016, me date: 02.02.2017

**Sekretarja Juridike,
Fatmire Kastrati**

**Kryetari i trupit gjykues,
Xheladin Osmani**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afatë prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën së Apelit në Prishtinë.